



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1438/1 të datës 21.03.2023 me pretendimet për pagesë të vonuar të ndihmës së kujdesit për përfituesit, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja përcaktoi se, në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-1438/1 të datës 21.03.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 21.03.2023, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim me pretendime për vonesë në pagesë të ndihmës për përkujdesje për përfituesit dhe është formuar lënda me numër 12-1438/1, datë 21.03.2023.

Në denoncim thuhet se kujdesi për përfituesit është vonuar për gjysmë viti dhe kërkuesi pyet nëse është duke u përgatitur një ofrim i rregulluar i kujdesit ndërmjet organeve konsullore, përfaqësuesve të shtëpive të të moshuarve dhe ndonjë ndërmjetës tjetër. Gjithashtu tregon se për personat me sëmundje progresive nuk është e nevojshme të paraqiten para këshillit dhe mjafton një diagnozë dhe të mos ndëshkohen familjarët duke ndërprerë kujdesin.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se pretendimet nuk tregojnë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga zyrtarë të caktuar, përkatësisht shprehet pakënaqësia me mënyrën e dhënies së dëmshpërblimit për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër, për të cilin KSHPK-ja nuk disponon elemente për veprim kompetent.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:
- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B:K:SH
Miratoi: K:N anëtar i KSHPK-së

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

